

VENDIM
Nr. 7, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
GJIROKASTËR SHA

(Ndryshuar me vendimin nr. 12, datë 18.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a., me shkresën 383 prot. datë 29.12.2022, plotësimet me anë të shkresës me nr. 383/1 prot., datë 25.1.2023 dhe nr. 324/1 prot. datë 10.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Gjirokastër sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. (NUIS M23329601L) është themeluar më datë 22.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Gjirokastër me 21.24%, Tepelenë me 4.57%, Këlcyrë me 2.81%, Përmet me 7.65%, Libohovë me 2.46%, Dropull me 7.05%, Memaliaj me 3.22%;

b) shoqëria rajonale UK Gjirokastër sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 128 156 banorë të bashkive: Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull, Memaliaj;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Bashkim Tola është diplomuar në Universitetin Politeknik në Inxhinieri e shpimit të puseve të z. Bashkim Tola në vitin 1997 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Gjirokastër sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe

kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Gjirokastër sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. me (NUIS M23329601L), në kategoritë:

a) kategoria A: “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;

b) kategoria C: “Për largimin e ujërave të ndotura”.

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Gentian Llogo;

b) drejtues teknik: znj. Çelestina Dajlani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. janë bashkitë: Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull, Memaliaj.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 56, datë 28.10.2019, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr. 192, datë 14.5.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 432, datë 11.11.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 519, datë 21.12.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Memaliaj sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**